



Data 20.09.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Riparim mirëmbajtje e sistemit hidro-mekaniko-elektrik të MZSH dhe rimbushje e kolaudimin e fikëseve të zjarrit në godinat spitalore të QSUNT”, për 24 muaj.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Fikëse zjarri 44482100-3

Hidrantë zjarri 44482200-4

Riparime dhe mirëmbajtje impiantesh 45259000-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 7 106 366.67 (shtatë milion e njëqind e gjashtë e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) **Lekë pa TVSH** dhe **8 527 640** (tetë milion e pesëqind e njetetë e shtatë e gjashtëqind e dyzetë mijë) **Lekë me TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, bazuar në nenin 74, pika 4, kriteret e vecanta të kualifikimit janë hartuar nga specialisti i fushës si dhe bazuar në relacionin me nr. 996/12 prot., datë 30.05.2024 të procedurës së prokurimit me objekt: “Riparim mirëmbajtje e sistemit hidro-mekaniko-elektrik të MZSH dhe rimbushje e kolaudimin e fikëseve të zjarrit në godinat spitalore të QSUNT”, për 24 muaj, kriteret e tjera janë miratuar nga Njësia e prokurimit bazuar në nenin 74 të VKM nr. 285, autoriteti/enti kontraktor “Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. **Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

- a) Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i licencuar për ushtrimin e aktivitetit sipas objektit të prokurimit. Për këtë duhet të paraqesë **licensë profesionale** lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me kod **I.2.A**, të kategorisë “Shërbim ekspertizë dhe/ose profesionale të mbrojtjes civile”.

Argumentimi: Ky kriter bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Ligji nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Gatishmëria dhe efikasiteti i fikëseve të zjarrit është shumë i rëndësishëm për parandalimin dhe sigurinë e godinave, stafit mjekësor dhe ndihmës, pacientëve, familjarëve etj. prandaj shërbimi për rimbushje i pajisjeve kundër zjarrit të përdorura duhet realizuar nga një subjekt i licencuar sipas përcaktimeve ligjore.

- b) Operatori duhet të ketë certifikatën **ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”**, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.
- c) Operatori, duhet të ketë certifikatën **ISO 45001-2018 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”** në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.
- d) Operatori, duhet të ketë certifikatën **ISO 14001-2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”** në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mësipërme.

Argumentimi: Kriteret **b, c dhe d** janë vendosur në përputhje me germen “c” të pikës 1 të nenit 77 të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, nenit 44 të VKM nr. 285 dt.19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 ‘Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik’, rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr.3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr.145 prot, date 16.03.2018 ‘Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë’.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (**2021, 2022 dhe 2023**) ku vlera e tyre të jete **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.**

Shënim:* Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme për të cilën ofrohet, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” në pikën 2.10 të njoftimit të kontratës.

Nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

Argumentimi: Ky kriter, është vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", [...]: Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës....., si dhe pika 1 dhe 2 e nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatoriekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit "Shërbimkonsulencë".

Vendosja e ketyre kritereve behet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet paraqitjes se kerkuara me larte, se zoterojne kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Legjislatori në nenin 55/4 të VKM 285/2021 ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur të Thjeshtuar, e cila është 40 % e Fondit Limit të kontratës së shpallur. AK është e vetmja qendër terciare në RSH për këtë arsye praktika e vendosur ndër vite e cila ka rezultuar e suksesshme, është ajo e marzheve maksimale të përcaktuara nga legjislatori në Rregullat e Prokurimit Publik si dhe në Legjislacionin e Prokurimit Publik në tërësi.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;** si dhe nenin 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.3 Kapaciteti teknik:

a) Dëshmi nga operatori ekonomik për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë **jo më e vogël 20% e vlerës së fondit limit** dhe **që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen **vërtetime të lëshuara nga një autoritet / ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës së bashku me kontratën e lidhur dhe / ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, **ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**

Shënim*: Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, shumat e mësipërme do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar për këtë procedurë prokurimi, **konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” ne piken 2.10 të njoftimit të kontratës.**

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me gërmes c, te pikes 1 dhe pika 4 te nenit 77 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020, ”Për prokurimin publik”, në nenin 55/4 të VKM 285/2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentat e tenderit te procedurave te prokurimit publik”.

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

b) Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf për kryerjen e shërbimit, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, me dokument certifikues (*diplome dhe/ose dëshmi kualifikimi*) për profilin profesional të kërkuar, lëshuar nga institucione publike apo private të akredituara për certifikimin e punonjësve sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- 2 Punonjës për shërbimin e mirëmbajtjes së pajisjeve kundër zjarrit.
- 1 Punonjës hidrik /ose/ mekanik për shërbimin e mirëmbajtjes të sistemit të MZSH-së nga elektropompat deri tek hidrante.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Ky numer është kërkuar duke u bazuar në numrin e objekteve në të cilat do të kryhen shërbimet si dhe natyrën dhe numrin e shërbimeve që kërkohen. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit në kohe dhe në cilesi.

- c) Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar **1 (një) Ekspert Zjarrfikës** për kryerjen e shërbimit. Për të provuar kapacitetet teknike të kërkuara sipas këtij kriteri, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë për ekspertin zjarrfikës:
- Çertifikatë profesionale e ekspertit zjarrfikës të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH).
 - Kontratë individuale pune, e vlefshme për të gjithë kohëzgjatjen e marrëveshjes kuadër;
 - Jetëshkrim (CV)

***Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe referuar pikës 3 të rekomandimit të APP-së nr. 5168 prot., datë 18.07.2024 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit publik për mallra, punë, shërbime”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. “Ekspert privat zjarrfikës” është personi fizik dhe juridik, i çertifikuar, i cili harton projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, kryen trajnime në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi si dhe kryen akt ekspertimin për zjarret e rena. Ky numer minimal është kërkuar duke u bazuar në numrin e objekteve në të cilat do të kryhen shërbimet si dhe natyrën dhe numrin e shërbimeve që kërkohen.

- ç) Operatori ekonomik ofertues duhet të **deklarojë**, që merr përsipër çdo lloj mbulimi me mjete transporti për çdo nevojë që del gjatë zbatimit të kontratës objekt prokurimi si dhe se sasia e fikëseve të zjarrit që do të merret nga OE me procesverbal për rimbushje dhe kolaudim, do të bëhet me faza duke patur parasysh që shërbimi të mos mbetet i pambuluar me fikëse gjatë kësaj periudhe. OE duhet të mbulojë AK me fikëse në përdorim gjatë kësaj kohe.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 ç) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që disponojnë mjetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

- d) Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) makineri për rimbushjen dhe kolaudimin e fikseve të zjarrit dhe të paraqesë:
- Dokumentacion vërtetues për disponimin e saj (akt zhdoganimi dhe/ose faturë tatimore blerje dhe/ose çdo dokumentacion ligjor që e vërteton pronësinë, apo huapërdorjen). Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
 - Dokumente me të dhënat teknike të pajisjes (katalog/skede teknike/ose cdo dokument tjetër) ku të specifikohet qartë paisja, funksioni dhe proceset e saj të punës dhe foto të pajisjes e cila ndodhet në mjediset e operatorit ekonomik ofertues).
- Autoritetit kontraktor i lind e drejta që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave të verifikojë në vend disponimin e pajisjes së kërkuar në mjediset e operatorit ekonomik ofertues.

***Shënim:** Ky kriter (germa d) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë shërbimet për rimbushjen dhe kolaudimin e pajisjeve kundër zjarrit, të cilat duhet të realizohen sipas specifikimeve teknike, duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, makinerinë e përcaktuar më sipër. Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është çmuar si e nevojshme zotërimi i makinerive specifike, e konsideruar nga AK si e domosdoshme për realizimin e shërbimit.

- dh) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **autorizim nga firma prodhuese / distributori i autorizuar i prodhuesit**, (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) **per mallrat Pluhur ABC 40%, Shkumë AFFF (6%), Gaz FM-200, CO2**. Autorizimi duhet të jetë origjinal dhe nëse nuk është në gjuhën shqipe, të përkthehet në gjuhën shqipe dhe të noterizohet.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 41, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen për shërbimet objekt prokurimi që janë prodhuar në përputhje me standardet dhe cilësitë e kërkuara në DST. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

- e) Operatori ekonomik ofertues për produktet: **Pluhur ABC 40%**, Shkumë **AFFF (6%)**, **Gaz FM-200, CO2**, duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor: Katalogë/fragmente të katalogut ose skedat teknike të publikuara nën autoritetin e prodhuesit për produktet e lartpërmendura. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuara në DST me qëllim që autoriteti kontraktor verifikojë përputhshmërinë me përcaktimet e DST.

Argumentimi: Ky kriter është në përputhje me nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik, si dhe me pikën 6/b të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se:[...] 6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:[...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].* Paraqitja e katalogjeve për të gjithë artikujt që janë objekt prokurimi, është kërkuar me qëllim verifikimin e përpueshmërisë së produkteve (**Pluhur ABC 40%**, Shkumë **AFFF (6%)**, **Gaz FM-200, CO2**) që operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike të përcaktuara në DST në Shtojcën 5.

- ë) OE duhet të paraqesë një autodeklaratë për çdo shërbim rimbushje/kolaudim të kryer, ku të pasqyrojë datën, sasine e specifikën e fikeseve/sistemit që ka kolauduar, ambientin ku ndodhen, si dhe vlefshmërinë për periudhën e garancisë nga momenti i rimbushjes/kolaudimit.

Argumentimi: Ky kriter është në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2024 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me pikën 6 të nenit 41, pika 6 ku parashikohet se “ *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektivit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*”

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 5.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Argumentimi: Specifikimet teknike janë miratuar nga anëtarët e njësisë së prokurimit që kanë specialitetin përkatës, në bazë të relacionit me nr. 996/12 prot., datë 30.05.2024 të procedurës së prokurimit me objekt: “Riparim mirëmbajtje e sistemit hidro-mekaniko-elektrik të MZSH dhe rimbushje e kolaudimit të fikeseve të zjarrit në godinat spitalore të QSUNT”, për 24 muaj dhe në përputhje me Ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenet 4, pika 38, si dhe nenin 36, dhe VKM-së Nr. 285/2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, është një kompleks spitalor, i cili shtrihet në një sipërfaqe prej rreth 15.95 hektarësh, ku gjenden rreth 20 godina spitalore dhe ndërtesa të tjera ndihmëse.

Të gjitha godinat në QSUT, qofshin godina teknike apo spitalore, janë të pajisura me sistem Hidrant si dhe me fikse zjarri të përmasave dhe tipeve të ndryshme (me mbushje me CO₂, pluhur ABC ose FM-200) në përshtatje me ambientin për të cilin janë përzgjedhur.

Këto sisteme mundësojnë parandalimin e ngjarjeve të jashtëzakonshme dhe rrisin sigurinë në ambiente dhe objekte që mund të kenë kërcënim të rënies së zjarrit.

Kontrolli dhe mirëmbajtja e tyre është shumë e rëndësishme në mënyrë që të ndërmerren masat paraprake të nevojshme, për të parandaluar dhe për të ulur sa më shumë të jetë e mundur kërcënimet për sigurinë e shëndetit të gjithësecilit, qoftë të pacientëve, të punonjësve (staf mjekësor e ndihmës), si dhe personave të tjerë (familjarë, studentë etj.,) **në zbatim të Ligjit Nr. 10 237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”**; si dhe të respektohen detyrimet që rrjedhin nga **Ligji Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes ndaj zjarrit dhe shpëtimit”** ku parashikohet: **Neni 38 pika c)** kontrolli, të paktën një herë në vit, i gjendjes së masave, mjeteve dhe pajisjeve për sigurinë nga zjarri dhe shpëtimit, në objektet dhe aktivitetet ku ushtrohet veprimtaria.

Për sa më sipër, **Operatori Ekonomik**, duhet të përmbushë minimalisht këto kritere:

- ✓ Të disponojë kapacitetet teknike dhe profesionale të nevojshme, me staf të trajnuar profesionalisht për ekzekutimin e këtij objekti prokurimi, në përputhje me normativat ligjore të **Ligjit Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes ndaj zjarrit dhe shpëtimit”**, si dhe me rregullat dhe standardet ndërkombëtare për sigurinë nga zjarri;
- ✓ Të ketë licencë/certifikatë të lëshuar nga Ministria e Brendshme/ Drejtoria e MNZSH, për ekzekutimin e këtij objekti prokurimi.
- ✓ Të gjitha materialet që përdoren për riparime dhe furnizim vendosje duhet të jenë të certifikuara (CE), pëfshirë dhe lëndët shuarse për rimbushjen e fikëseve të zjarrit (Shkumë, CO₂, Pluhur ABC 40%).

1. Kontrolli dhe mirëmbajtja teknike e sistemit hidro-mekaniko-elektrik të MZSH në godinat ku janë të instaluar (nga elektropompa deri në kasetat e hidranteve).

Sistemi Hidrant ka si qëllim kryesor dhënien e ndihmës së parë në operacionet e shuarjes së zjarrit në fillim të tij, duke ndihmuar efektivat e zjarrfikësve ose personelin tjetër të trajnuar më pare, për të kontrolluar përhapjen dhe zvogëlimin e përmasave të tij.

QSUT i disponon të dy llojet e hidranteve: si **hidrante të brendshme** ashtu edhe **hidrante të jashtme** të instaluar në natyrë.

- Hidrantet e instaluar në natyrë janë 14 copë, të stacionuara në pikat kyçe si: 1 pranë Sp. Neurokirurgjisë, 1 tek Kaldaja Qendrore, 1 tek Pediatria e Re, 4 para dhe pas Sp. A1, 4 rreth Spitalit A2, 1 tek Depo e Re Farmaceutike, 1 tek Qendra e Konsultave, dhe 1 tek Spitali Infektiv.
- Hidrantet e brendshme janë **tip kasetë** dhe janë të instaluar në çdo godinë, sipas parametrave të duhura për sa i përket distancës, mbulimit që parashikohet dhe të kompletuara me të gjitha pajisjet e hidrantit.

Në godinat ekzistuese të Qsut hidrantet kasetë furnizohen me ujë nga linja e rrjetit që furnizon edhe këto godina, me anë të sistemit të pompave.

Ndërsa në godinat si Qendra Teknike dhe godinat e rikonstruara si: Spitali A1, Spitali A2, Pediatri e Re, Spitali Infektiv, Qendra e Konsultave dhe Depo e Re Farmaceutike janë të pajisura me sistem të panvarur MNZSH, me elektropompa (me energji dhe gjenerator në rast mungesë

energjie), të cilat furnizojnë me ujë hidrantet kasetë nëpërmjet një linje më vete nga linja e furnizimit me ujë të pijshëm të godinës.

Testimi periodik i sistemit hidrant është një element i rëndësishëm për përcaktimin e saktë të gjendjes funksionale të tij. Nëpërmjet testimit përcaktojmë gjendjen e përgjithshme të funksionimit të shpërndarjes të ujit, kontrollin e funksionimit të valvulave, kontrollin e presionit të ujit, si dhe kontrollin e pajisjeve të përbërëse në sistemin hidrant. Një sistem hidrant i mirëmbajtur mundëson parandalimin e ngjarjeve të jashtëzakonshme dhe rrit sigurinë në ambiente dhe objekte që mund të kenë kërcënim të rëniës së zjarrit.

Kontrolli, mirëmbajtja dhe testimi i sistemit hidro-mekaniko-elektrik të MZSH në godinat ku janë të instaluara nga elektropompa/gjeneratori deri në kasetat e hidranteve, përfshirë dhe panelin përkatës të funksionimit, përfshin:

- Testim i Sistemit hidrant çdo vit për pajisjet që janë vizualisht të prekshme si: saracineska, tubat hidrantë të gomuar, valvulat, rekorderitë lidhëse, kasetat dhe sprucatorët.
- Vlerësim të furnizimit me ujë të sistemit, duke kontrolluar dhe presionin në BAR (elektropompat).
- Testim mbi mundësinë e rrjedhjeve të rekorderive dhe tubit hidrant nën presion.
- Testimi i sistemit të pompimit, si dhe shpërndarja e ujit në të gjitha linjat, të cilat duhet të disponojnë presionin e kërkuar për çdo pajisje.
- Kontroll dhe testim të motogjenetarorëve të sistemit dhe baterive të tyre.
- Testimi i hidrantit duhet të ketë si parim dhe ruajtjen e presionit të vazhdueshëm deri në përfundim të procesit të testimit.
- Kontroll i panelit (elektrike dhe mekanik) përkatës të funksionimit.

Kontrolli, mirëmbajtja dhe testimi i Sistemeve të fikjes automatike me FM200 të Akseleratorit Onkologjik (sisteme 2 copë) përfshijnë këto teste çdo vit:

- Kontroll i panelit të komandimit;
- Kontrolli, pastrimi, dhe testimi i dedektorëve të tymit;
- Kontrolli, pastrimi, dhe testimi i dedektorëve të nxehtësisë;
- Kontrolli i sirenës;
- Kontrolli i butonave;
- Kontroll, testim i kabllove të zjarrit;
- Kontroll vizual i bombulës dhe presioni i saj;
- Kontrolli dhe testimi i elektrovalvulës;
- Kontrolli i lidhjeve të tubacioneve dhe difuzorëve;
- Pastrimi i tubave të shkarkimit të bombulave;
- Testim i plotë i sistemit në boshllëk;
- Vendosija në punë e sistemeve;
- Vendosija e etiketave me të dhënat e bombulës, kontrollit të ardhshëm dhe vulosjen e butonave të shkarkimit manual në central dhe në bombul.

2. Rimbushja dhe kolaudimi i fikëseve të zjarrit

Çdo ambient teknik apo spitalor ka të instaluara fikëset e zjarrit për parandalimin e ngjarjeve të jashtëzakonshme. Shumica e fikëseve të zjarrit janë kryesisht portative, përveç fikëseve të mëdha në ambientet teknike apo akseleratorëve të cilat janë të lëvizshme me rrotat mbajtëse (50 kg dhe 100 kg).

- Fikëset 2 kg dhe 5 kg janë të tipit B, C me CO₂.
- Fikëset 3 kg, 6 kg, 9 kg, 12 kg, 50 kg dhe 100 kg janë të tipit ABC me pudër (përveç 2 fikëseve 50 kg që janë me shkumë).
- Fikëset e zjarrit të akseleratorit të Onkologjikut janë të tipit FM-200, 152.4 kg.

Mirëmbajtja e fikëve të zjarrit është e rëndësishme për sigurinë e të gjithëve, qofshin staf mjekësor, staf ndihmës, pacientë, familjarë, apo studentë.

- Secila fikse zjarri do të rimbushet me CO₂/pluhur/shkumë/FM-200, sipas llojit, si dhe kolaudohet një herë në vit, në varësi të datës së skadencës së gjithësecilës.

Gjatë rimbushjes duhet të kihet parasysh që:

- Presioni të jetë në nivelin e rekomanduar.
- Në fikëset e zjarrit të pajisura me manometër, gjilpëra duhet të jetë në zonën jeshile, as shumë lart, as shumë poshtë.
- Teli sigures dhe vula (në qoftë se ka) duhet të jetë e paprekur.
- Nuk duhet të ketë goditje të jashtme, rrjedhje, ndryshk, depozita kimike ose shenja të tjera abuzimi ose përdorimi. Fshi çdo kimikat, vaj, etj., që mund të jetë depozituar në fikse.
- Në çdo bombul të jetë: lloji i materialit mbushes & klasi, sasia, instruktimi i përdorimit në gjuhën shqipe së bashku me logon e subjektit, kohën e rimbushjes (data, muaji, viti), afati i skadimit.
- Për fikset e zjarrit me pluhur dhe shkumë përveç etiketës së garancisë do të vendoset edhe unaza plastike e garancisë me ngjyrën e miratur nga organizmat ndërkombëtare ku ka të stampuar muajin dhe vitin e kryerjes së shërbimit.
- Dalja e bombulave nga impianti do të shoqërohet me procesverbal nga të dyja palët.
- Afati i kryerjes së rimbushjes së bombulave, do të diskutohet paraprakisht nga të dyja palët në momentin e lidhjes së kontratës.

Argumentimi: Grafiku i lëvrimit është miratuar nga anetaret e njesise se prokurimit qe kane specialitetin perkates, ne baze te shkreses relacionit me nr. 996/12 prot., datë 30.05.2024 të procedurës së prokurimit me objekt: “Riparim mirëmbajtje e sistemit hidro-mekaniko-elektrik të MZSH dhe rimbushje e kolaudimit të fikëseve të zjarrit në godinat spitalore të QSUNT”, për 24 muaj te miratuara dhe nga Titullari i Autoritetit Kontraktor dhe ne perputhje me Ligjin nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik”, te ndryshuar, dhe nenin 41(1) të VKM-se Nr. 285/2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, te ndryshuar, ku parashikohet se “1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

Shtojca 7

TERMAT E REFERENCES

"Riparim mirëmbajtje e sistemit hidro-mekaniko-elektrik të MZSH dhe rimbushje/kolaudim i fikëseve të zjarrit në godinat spitalore të QSUNT, për 24 muaj".

Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", është një kompleks spitalor, i cili shtrihet në një sipërfaqe prej rreth 15.95 hektarësh, ku gjenden rreth 20 godina spitalore dhe ndërtesa të tjera ndihmëse.

Të gjitha godinat në QSUT, qofshin godina teknike apo spitalore, janë të pajisura me sistem Hidrant si dhe me fikse zjarri të përmasave dhe tipeve të ndryshme (me mbushje me CO₂, pluhur ABC ose FM-200) në përshtatje me ambientin për të cilin janë përzgjedhur.

Këto sisteme mundësojnë parandalimin e ngjarjeve të jashtëzakonshme dhe rrisin sigurinë në ambiente dhe objekte që mund të kenë kërcënim të rënies së zjarrit.

Kontrolli dhe mirëmbajtja e tyre është shumë e rëndësishme në mënyrë që të ndërmerren masat paraprake të nevojshme, për të parandaluar dhe për të ulur sa më shumë të jetë e mundur kërcënimet për sigurinë e shëndetit të gjithësecilit, qoftë të pacientëve, të punonjësve (staf mjekësor e ndihmës), si dhe personave të tjerë (familjarë, studentë etj..) **në zbatim të Ligjit Nr. 10 237, datë 18.2.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë"**; si dhe të respektohen detyrimet që rrjedhin nga **Ligji Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes ndaj zjarrit dhe shpëtimin"** ku parashikohet: **Neni 38 pika c)** kontrolli, të paktën një herë në vit, i gjendjes së masave, mjeteve dhe pajisjeve për sigurinë nga zjarri dhe shpëtimin, në objektet dhe aktivitetet ku ushtrohet veprimtaria.

Për sa më sipër, **Operatori Ekonomik**, duhet të përmbushë minimalisht këto kritere:

- ✓ Të disponojë kapacitetet teknike dhe profesionale të nevojshme, me staf të trajnuar profesionalisht për ekzekutimin e këtij objekti prokurimi, në përputhje me normativat ligjore të **Ligjit Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes ndaj zjarrit dhe shpëtimin"**, si dhe me rregullat dhe standardet ndërkombëtare për sigurinë nga zjarri;
- ✓ Të ketë licencë/certifikatë të lëshuar nga Ministria e Brendshme/ Drejtoria e MNZSH, për ekzekutimin e këtij objekti prokurimi.
- ✓ Të gjitha materialet që përdoren për riparime dhe furnizim vendosje duhet të jenë të certifikuara (CE), pëfshirë dhe lëndët shuarse për rimbushjen e fikëseve të zjarrit (Shkumë, CO₂, Pluhur ABC 40%).

3. Kontrolli dhe mirëmbajtja teknike e sistemit hidro-mekaniko-elektrik të MZSH në godinat ku janë të instaluar (nga elektropompa deri në kasetat e hidranteve).

Sistemi Hidrant ka si qëllim kryesor dhënien e ndihmës së parë në operacionet e shuarjes së zjarrit në fillim të tij, duke ndihmuar efektivat e zjarrfikësve ose personelin tjetër të trajnuar më pare, për të kontrolluar përhapjen dhe zvogëlimin e përmasave të tij.

QSUT i disponon të dy llojet e hidranteve: si **hidrante të brendshme** ashtu edhe **hidrante të jashtme** të instaluar në natyrë.

- Hidrantet e instaluar në natyrë janë 14 copë, të stacionuara në pikat kyçe si: 1 pranë Sp. Neurokirurgjisë, 1 tek Kaldaja Qendrore, 1 tek Pediatria e Re, 4 para dhe pas Sp. A1, 4 rreth Spitalit A2, 1 tek Depo e Re Farmaceutike, 1 tek Qendra e Konsultave, dhe 1 tek Spitali Infektiv.

- Hidrantet e brendshme janë **tip kasetë** dhe janë të instaluara në çdo godinë, sipas parametrave të duhura për sa i përket distancës, mbulimit që parashikohet dhe të kompletuara me të gjitha pajisjet e hidrantit.

Në godinat ekzistuese të QSUT hidrantet kasetë furnizohen me ujë nga linja e rrjetit që furnizon edhe këto godina, me anë të sistemit të pompave.

Ndërsa në godinat si Qendra Teknike dhe godinat e rikonstruara si: Spitali A1, Spitali A2, Pediatri e Re, Spitali Infektiv, Qendra e Konsultave dhe Depo e Re Farmaceutike janë të pajisura me sistem të panvarur MNZSH, me elektropompa (me energji dhe gjenerator në rast mungesë energjie), të cilat furnizojnë me ujë hidrantet kasetë nëpërmjet një linje më vete nga linja e furnizimit me ujë të pijshëm të godinës.

Testimi periodik i sistemit hidrant është një element i rëndësishëm për përcaktimin e saktë të gjendjes funksionale të tij. Nëpërmjet testimit përcaktojmë gjendjen e përgjithshme të funksionimit të shpërndarjes të ujit, kontrollin e funksionimit të valvulave, kontrollin e presionit të ujit, si dhe kontrollin e pajisjeve të përbërëse në sistemin hidrant. Një sistem hidrant i mirëmbajtur mundëson parandalimin e ngjarjeve të jashtëzakonshme dhe rrit sigurinë në ambiente dhe objekte që mund të kenë kërcënim të rëniës së zjarrit.

Kontrolli, mirëmbajtja dhe testimi i sistemit hidro-mekaniko-elektrik të MZSH në godinat ku janë të instaluara nga elektropompa/gjeneratori deri në kasetat e hidranteve, përfshirë dhe panelin përkatës të funksionimit, përfshin:

- Testim i Sistemit hidrant çdo vit për pajisjet që janë vizualisht të prekshme si: saracineska, tubat hidrantë të gomuar, valvulat, rekorderitë lidhëse, kasetat dhe sprucatorët.
- Vlerësim të furnizimit me ujë të sistemit, duke kontrolluar dhe presionin në BAR (elektropompat).
- Testim mbi mundësinë e rrjedhjeve të rekorderive dhe tubit hidrant nën presion.
- Testimi i sistemit të pompimit, si dhe shpërndarja e ujit në të gjitha linjat, të cilat duhet të disponojnë presionin e kërkuar për çdo pajisje.
- Kontroll dhe testim të motogjenetarorëve të sistemit dhe baterive të tyre.
- Testimi i hidrantit duhet të ketë si parim dhe ruajtjen e presionit të vazhdueshëm deri në përfundim të procesit të testimit.
- Kontroll i panelit (elektrike dhe mekanik) përkatës të funksionimit.

Kontrolli, mirëmbajtja dhe testimi i Sistemeve të fikjes automatike me FM200 të Akseleratorit Onkologjik (sisteme 2 copë) përfshijnë këto teste çdo vit:

- Kontroll i panelit të komandimit;
- Kontrolli, pastrimi, dhe testimi i dedektorëve të tymit;
- Kontrolli, pastrimi, dhe testimi i dedektorëve të nxehtësisë;
- Kontrolli i sirenës;
- Kontrolli i butonave;
- Kontroll, testim i kablllove të zjarrit;
- Kontroll vizual i bombulës dhe presioni i saj;
- Kontrolli dhe testimi i elektrovalvulës;
- Kontrolli i lidhjeve të tubacioneve dhe difuzorëve;
- Pastrimi i tubave të shkarkimit të bombulave;

- Testim i plotë i sistemit në boshllëk;
- Vendosja në punë e sistemeve;
- Vendosja e etiketave me të dhënat e bombulës, kontrollit të ardhshëm dhe vulosjen e butonave të shkarkimit manual në central dhe në bombul.

4. Rimbushja dhe kolaudimi i fikëseve të zjarrit

Çdo ambient teknik apo spitalor ka të instaluara fikëset e zjarrit për parandalimin e ngjarjeve të jashtëzakonshme. Shumica e fikëseve të zjarrit janë kryesisht portative, përveç fikëseve të mëdha në ambientet teknike apo akseleratorëve të cilat janë të lëvizshme me rrotat mbajtëse (50 kg dhe 100 kg).

- Fikëset 2 kg dhe 5 kg janë të tipit B, C me CO₂.
- Fikëset 3 kg, 6 kg, 9 kg, 12 kg, 50 kg dhe 100 kg janë të tipit ABC me pudër (përveç 2 fikëseve 50 kg që janë me shkumë).
- Fikëset e zjarrit të akseleratorit të Onkologjikut janë të tipit FM-200, 152.4 kg.

Mirëmbajtja e fikëseve të zjarrit është e rëndësishme për sigurinë e të gjithëve, qofshin staf mjekësor, staf ndihmës, pacientë, familjarë, apo studentë.

- Secila fikse zjarri do të rimbushet me CO₂/pluhur/shkumë/FM-200, sipas llojit, si dhe kolaudohet një herë në vit, në varësi të datës së skadencës së gjithësecilës.

Gjatë rimbushjes duhet të kihet parasysh që:

- Presioni të jetë në nivelin e rekomanduar.
- Në fikëset e zjarrit të pajisura me manometër, gjilpëra duhet të jetë në zonën jeshile, as shumë lart, as shumë poshtë.
- Teli sigures dhe vula (në qoftë se ka) duhet të jetë e paprekur.
- Nuk duhet të ketë goditje të jashtme, rrjedhje, ndryshk, depozita kimike ose shenja të tjera abuzimi ose përdorimi. Fshi çdo kimikat, vaj, etj., që mund të jetë depozituar në fikse.
- Në çdo bombul të jetë: lloji i materialit mbushes & klasi, sasia, instruktimi i përdorimit në gjuhën shqipe së bashku me logon e subjektit, kohën e rimbushjes (data, muaji, viti), afati i skadimit.
- Për fikset e zjarrit me pluhur dhe shkumë përveç etiketës së garancisë do të vendoset edhe unaza plastike e garancisë me ngjyrën e miratur nga organizmat ndërkombëtare ku ka të stampuar muajin dhe vitin e kryerjes së shërbimit.
- Dalja e bombulave nga impianti do të shoqërohet me procesverbal nga të dyja palët.
- Afati i kryerjes së rimbushjes së bombulave, do të diskutohet paraprakisht nga të dyja palët në momentin e lidhjes së kontratës.

❖ Vendi i kryerjes së riparim-shërbimeve për këtë procedurë prokurimi është:

- ✓ Godinat e Shërbimit Spitalor;
- ✓ Galeria Lidhëse (ku kalojnë të gjitha rrjetet shpërndarëse të energjisë, ujit të ftohtë dhe ngrohtë, avullit, etj.);
- ✓ Godinat Teknike, ku janë të instaluara;
- ✓ Ambientet ku janë instaluar 4 hidrantet e jashtme.

❖ **Grafiku i lëvrimit (koha e kryerjes së riparim-shërbimeve) për këtë procedurë prokurimi është:**

- ✓ Kontrollët, shërbimet teknike dhe riparimet e planifikuara periodike, do të kryhen sipas udhëzimeve nga përfaqësuesit e QSUT, duke njoftuar paraprakisht një ditë para OE dhe do të jepen me “Urdhër Pune”;
- ✓ Afati dhe koha e rimbushjes dhe kolaudimit të fikëseve të zjarrit do të diskutohet paraprakisht nga të dyja palët në momentin e lidhjes së kontratës dhe do të jepet me “Urdhër Pune” nga përfaqësuesit e QSUT.

Afatet e ekzekutimit:

- **24 Muaj nga nënshkrimi I Marrëveshjes Kuadër. Brenda vlefshmërisë së MK do të lidhen kontrata sipas nevojave të AK. Sasitë e pritshme pasqyrohen në tabelën më poshtë:**

Nr.	Përshkrimi i shërbimit dhe riparimit	Njësia	Sasitë e pritshme për 24 muaj
I.	Kontroll dhe mirëmbajtje e sistemit hidro-mekaniko-elektrik të MZSH		
1	Kontroll, mirëmbajtje dhe testim i sistemit hidro-mekaniko-elektrik të MZSH në godinat ku janë të instaluar: nga elektropompa, gjeneratori deri në kasetat e hidranteve, përfshirë dhe panelin përkatës të funksionimit.	orë pune	378
2	Kontroll, mirëmbajtje dhe testim i Sistemit të fikjes automatike me FM200 të Akseleratorit Onkologjik (copë 2)	orë pune	40
3	F.v rubinetë hidranti kasete e pajisur me volantini përkatës	copë	10
4	F.v tub hidranti i pajisur me spucatorin dhe me shllangat përkatëse nga të dyja anët, L-30 m-l	copë	14
5	F.v zëvendësim baterish 12 v 100 Ah për gjeneratorët MZSH	copë	16
6	F.v zëvendësim baterish 12 v 7 Ah (32 panele *2 bateri secili)	copë	128
7	F.v filtër ajri për gjeneratorët e disponueshëm	copë	2
8	F.v filtër karburanti për gjeneratorët e disponueshëm	copë	2
9	F.v filtër vaji për gjeneratorët e disponueshëm	copë	2
10	F.v vaj për gjeneratorët e disponueshëm	lt	20
11	F.v manometër presioni	copë	2
12	F.v komandare për enë zgjerimi Volum 100 lt	copë	8
II.	Rimbushja dhe kolaudimi i fikëseve të zjarrit		
1	Rimbushje e kolaudim fikse zjarri universale 2 kg (CO2)	copë	16
2	Rimbushje e kolaudim fikse zjarri universale 3 kg (pluhur ABC)	copë	30
3	Rimbushje e kolaudim fikse zjarri universale 5 kg (CO2)	copë	452
4	Rimbushje e kolaudim fikse zjarri universale 6 kg (pluhur ABC)	copë	542
5	Rimbushje e kolaudim fikse zjarri universale 9 kg (pluhur ABC)	copë	28
6	Rimbushje e kolaudim fikse zjarri universale 12 kg (pluhur ABC)	copë	88
7	Rimbushje e kolaudim fikse zjarri universale 50 kg (27 pluhur ABC, 2 shkume)	copë	58

8	Rimbushje e kolaudim fikse zjarri universale 100 kg (pluhur ABC)	copë	4
9	Rimbushje e kolaudim fikse zjarri FM-200 152.4 Kg (4 copë)	copë	8
10	F.v manometër për fikse zjarri	copë	20
11	F.v tub shkarkimi për fikese zjarri	copë	20
12	F.v valvul për fikse zjarri	copë	20

Inventari i pajisjeve:

INVENTARI I FIKËSEVE TË ZJARRIT

VITI 2024

NR	GODINA	Fikëse 2 Kg	Fikëse 3 Kg	Fikëse 5Kg	Fikëse 6 Kg	Fikëse 9 Kg	Fikëse 12 Kg	Fikëse 50 Kg	Fikëse 100 Kg	Fikëse FM-200
1	Drejtoria				4					
2	Statistika				4		6			
3	Farmaci Qendrore				5			3		
4	Magazina M2				2					
5	Magazina M1				15					
6	Kaldaja Qendrore	1		4				11	2	
7	Tankeri i oksigjenit Sp.2						1			
8	Sp. Kirurgjite e vjetra			2	19		1			
9	Sp. 6 katesh	1			31		2			
10	Sp.Francez	6			25					
11	Pediatri e Pergjithshme				11					
12	Pediatri e Re(Urgjenca)				36			3		
13	Pediatri e Pergjithshme(rikons)			50						
14	Spitali A1			36	12		31	8		
15	Spitali A2			128	4			2		
16	Sp. Onkologjik				17	14				
17	Akselatori Onkologjik									4
18	Qendra konsultave			4						
19	Sp. Infektiv				48					
20	Sp. Diegie-plastika			2	13		3	2		
21	Neurologji		15							
22	Neurokirurgji				11					
23	Psikiatri				8					
24	Psikiatri Infantile				6					
	TOTALI	8	15	226	271	14	44	29	2	4

	613	
--	-----	--

**INVENTARI I HIDRANTEVE TË ZJARRIT
VITI 2024**

NR	GODINA	HIDRANTE TE BRENDSHME	HIDRANTE TE JASHTME
1	Farmacit Qendrore	6	1
2	Kaldaja Qendrore+ Ambiente teknike	4	1
3	Pediatri e Pergjithshme (infektive)	5	0
4	Pediatri e Re(Urgjenca)	10	1
5	Spitali A1	39	4
6	Spitali A2	44	4
7	Sp. Onkologjik+ Akselerator	13	0
8	Qendra konsultave	3	1
9	Sp. Infektiv	24	1
10	Neurologji	15	0
11	Neurokirurgji	8	1
12	Psikiatri	4	0
	TOTALI	175	14
189			

**GODINAT ME SISTEM MNZSH ME ELEKTROPOMPA DHE
MOTOGJENERATORË ME KARBURANT TË PANVARUR**

VITI 2024

NR	Vendndodhja	ELEKTROPOMPA MZSH	Karakterisikat	GJENERATORE ME KARBURANT MZSH	
		Sasia (copë)		Sasia (copë)	Karakterisikat
1	Farmacit Qendrore	2	Dap 4.3 kw	0	
2	Qendra Teknike per Sp.A1	4	3 Dap 15 kw dhe 1 Dap 2.1 kw	1	Lombardini tip 9LD625/2
3	Pediatri e Re(Urgjenca)	3	2 Lowara 15 kw dhe Lowara 1 1.24 kw	1	Lombardini tip 9LD625/2
4	Spitali A2	2	Etna 30 Kw	1	Etna 41 Kw

5	Qendra konsultave	2	Foras 2.3kw dhe 9.8 kw	1	Lombardini
6	Sp. Infektiv	3	Duyar 2.2 kw dhe 18.5 kw	0	
	Totali	16		4	
SHENIM: CDO GJENERATORE ME KARBURANT KA 2 BATERI 12 V 100 APH					

Përlllogaritja e Fondit Limit, specifikimet teknike, termat e referencës, grafiku i ekzekutimit, sasia etj., janë vendosur ne mbështetje te Argumentimit të Fondit Limit **nr. 966/12 prot., datë 30.05.2024** “Relacion i grupit të punës për llogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe hartimin e nevojave për procedurën e prokurimit me objekt “Riparim mirlmbajtje e sistemit hidro – mekaniko – elektrik të MZSH dhe rimbushje/kolaudim i kifësve të zjarrit në godinat spitalore të QSUNT, për 24 muaj”, bashkelidhur kerkeses per rihapje procedure nga Drejtoria e Sherbimeve Mbështetëse me nr. 1381/9 Prot., datë 11.09.2024.

Akordimi i Fondit është miratuar nga Drejtoria Ekonomike dhe Planifikimit Financiar me Shkresën **nr. 1381/11 Prot, datë 19.09.2024.**

Periudha e vlefshmërisë së ofertave: **150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë.**

Kriteri i vlerësimit: **Çmimi më i ulët.**

Data e zhvillimit te tenderit te jete data **Data: 03.10.2024, Ora: 10:00**